

VENDIM
Nr.266, datë 5.3.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E ZNJ. ERMIRA SPAHIU, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, në zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 3 900 000 (tre milionë e nëntëqind mijë) lekë, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj.Ermira Spahiu, në Institutin Ortopedik Rizzoli, në Bolonja, Itali.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha